

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, V.Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PDIU, PBD**

Z. I. Celibashi: Mirëdita, fillojmë seancën publike. Në rendin e ditës kemi tre projektvendime:


Projektvendim “Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

Projektvendim “Për kompensimin financiar paszgjedhor që do t’u shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

Projektvendim “Për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020 dhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre”. Po, vazhdojmë me relatimin e pikës së parë të rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka detyrimin të përcaktojë me vendim vlerën në para të një vote të vlefshme. Referuar nenit 88 pika 2, KQZ-ja, brenda 10 ditëve nga nxjerrja e rezultatit perfundimtar në shkallë vendi përcakton me vendim vlerën në para të një vote të vlefshme, duke pjesëtuar fondin e

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*

përgjithshëm të miratuar , me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Komisioni Rregullator miratoi me Vendimin nr.21 datë 13.07.2021, rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Në lidhjen nr.1 bashkëlidhur vendimit, përcaktohen votat e vlefshme dhe përqindja për çdo subjekt pjesëmarrës në zgjedhje ku rezulton se, partitë që kanë përfiturar jo më pak se 1 % të votave dhe votat e vlefshme të grumbulluara prej tyre, janë si më poshtë: Partia Socialiste e Shqipërisë, Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Demokratike “Aleanca për Ndryshim” dhe Partia Socialdemokrate. Në bazë të nenit 180 pikës 4 të Kodit Zgjedhor para hyrjes në fuqi të këtij ligji fondi nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje përcaktohet se do të jetë 2 herë më i madh se fondi i alokuar për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017. Fondi i vënë në dispozicion në vitin zgjedhor 2017 ishte 65,000,000 lekë, pra rrjedhimisht u caktua që për vitin zgjedhor 2021 fondi i përgjithshëm i miratuar është 130,000,000 lekë. Pjestimi i fondit të përgjithshëm të miratuar me numrin total të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi rezulton të jetë 84,78, pra vota e vlefshme është ≈ 85 lekë. Për sa më lart, brenda kompetencave dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në “Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është paraqitur projektvendimi “Për përcaktimin e vlerës në para të një vote të vlefshme për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”.

Z. I. Celibashi: Përfaqësues të partive politike diskutime?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*


Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Dakord zoti Kryetar në lidhje me këtë relacion dhe projektvendim. Është në harmoni me ligjin, biem në dakordësi, nuk kemi kundërshtime.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, diskutime të tjera nuk kemi! Atëhere, Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2, nenin 88, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe Vendimit nr. 21 datë 13.07.2021 të Komisionit Rregullator “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”, Vendos:

1. Vlera në para e një vote të vlefshme është 85 (tetëdhjetë e pesë) lekë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 428

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për kompensimin financiar paszgjedhor që do t’u shpërndahej subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, V.Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PDIU, PBD**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, që ka të bëjë me kompensimin financiar paszgjedhor.

Z. Y. Merkaj: Neni 19, pika 1, shkronjat “k” e “n” dhe pika 2, e Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve lidhur me administrimin e buxhetit të KQZ-së sipas rregullave të fushës, të gjitha aspektet e financimit të fushatës zgjedhore. Neni 89, i Kodit Zgjedhor parashikon kompensim financiar paszgjedhor për subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje, të cilat nuk kanë përfituar fonde sipas nenit 88 të Kodit Zgjedhor. Vendimi nr.21 datë 13.07.2021 Komisioni Rregullator ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.04.2021. Në zbatim të neneve të mësipërme dhe vendimit të Komisionit Rregullator është hartuar projektvendimi “Për kompensimin financiar paszgjedhor që do t’u

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*

shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”. Ne këtë relacion janë paraqitur dhe pretendimet e ngritura nga Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë, pjesë e Koalicionit PD-AN, e cila ka paraqitur opiniomet dhe mendimet e saj. Qëllim i këtij projektvendimit është përcaktimi i subjekteve zgjedhore, të cilat kanë marrë jo më pak së 1 % të votave të vlefshme në shkallë vendi në zgjedhjet e datës 25 prill 2021 dhe që nuk kanë marrë kompensim para zgjedhor në mënyrë që të bëhet kompensimi i tyre paszgjedhor. Partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore që kanë përfituar fonde paradhënie të akorduara nga Buxheti i Shtetit në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, janë si më poshtë:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë;
2. Partia Demokratike;
3. Lëvizja Socialiste për Integrim;
4. Bindja Demokratike;
5. Partia Socialdemokrate;
6. Partia Republikane;
7. Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar;
8. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet;
9. Partia Fryma e Re Demokratike;
10. Partia Demokristiane e Shqipërisë.

Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021 të cilat nuk kanë përfituar fonde paradhënie dhe kanë marrë mandat në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë janë si më poshtë:

1. Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë;
2. Partia Lëvizja e Legalitetit;
3. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut.


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*

Nga Partia Agrare Ambientaliste, pjesë e Koalicionit PD-AN është ngritur pretendimi lidhur me projektvendimin, dhe janë dërguar mendime ku pretendohet se sipas numërit të votave të marra dhe mandatit të marrë në këto zgjedhje i takon të marrë kompensim pas zgjedhor. Referuar nenit 88, pika 3 të Kodit Zgjedhor, numri i votave të vlefshme takuese për tre partitë e sipërcituara, të cilat kanë marrë nga një mandat Shqipëri dhe janë pjesë e Koalicionit PD-AN, është 10.546 (dhjetë mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë), vlerë kjo e llogaritur duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre. Mesatarja e votave për mandat llogaritet duke pjestuar numrin e votave të vlefshme të koalicionit PD-AN sipas llogaritjeve i bie të jetë dhjetë mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë. Numri i votave të vlefshme në shkallë vendi është një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë dhe vlera 1% e tyre përlllogaritet pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një vota. Numri i votave të vlefshme takuese për partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje si pjesëtare të koalicionit PD-AN, të cilat nuk përfituan fonde para zgjedhjeve është dhjetë mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë vota. Duke qenë se numri i votave të vlefshme për këto parti politike është më i vogël se pragu 1%, atëherë ato nuk përfitojnë kompensim financiar paszgjedhor. Për sa më sipër, është përgatitur projektvendimi “Për kompensimin financiar paszgjedhor që do t’u shpërndahet subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”, pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Gjithashtu me vendimin nr. 27, datë 17.07.2021, Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar pretendimin e Partisë Republikane, e cila ka kërkuar shfuqizimin e fjalisë së dytë, paragrafi i tretë, të nenit 88, ku kërkon pikërisht vlerësimin e votave mesatare, pjesë e koalicionit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*


Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë me pak fjalë, partitë politike të cilat kanë qenë të regjistruara si subjekte zgjedhore, kanë përfituruar fonde paradhënie për zgjedhjet e 25 prillit. Janë 10 parti politike. PSSH, PD, LSI, BD, PSD, PR, LZHK, PDIU, FRD, PDK. Ju e keni bërë llogaritjen e 1%. 1% është pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një vota. Që një parti pas zgjedhjeve të kompensohet do të duhet të ketë kaluar këtë 1%. Nga partitë të cilat nuk kanë përfituruar fonde janë tre PAA, PLL dhe PBDNJ, Pasi partitë e tjera kanë përfituruar fonde. Këto tre parti që të kompensoheshin do të duhej të kalonin 1%. Asnjëra prej tyre nuk e ka kaluar 1%. Pra, nuk ka marrë pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një vota dhe për këtë arsye nuk mund të kompensohen. Kjo është ideja.

Diskutime nga përfaqësuesit e partive?

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Po faleminderit zoti Kryetar! Doja t'i bëj një pyetje administratës, përsa i përket Koalicionit PD-AN për subjektin tonë. Për se nuk është vendosur në këtë relacion sepse ajo tashmë e ka kaluar 1% të votave pra shumë pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një vota. Ka marrë diku tek nëntëmbëdhjetë mijë vota. Pyetja është: a do të duhej ta përcaktonit në projektvendim administrata, përsa i përket koalicionit, sepse është e vetmja forcë e cila i ka marrë. Pra, duhet të jetë e përcaktuar që PDIU ka të drejtën e kompensimit, sepse e ka kaluar 1% në bazë të ligjit, në bazë të nenit 83, pika 3.

Znj. V. Ballgjini: Ky projektvendim është në lidhje me kompensimin financiar pas zgjedhor. Referuar nenit 89, përfitojnë fonde pas zgjedhore ato parti të cilat nuk kanë fituar para zgjedhore. Me sa rezulton ju keni përfituruar fonde para zgjedhore pese milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë lekë. Rrjedhimisht përjashtoheni nga ky projektvendim, sepse keni marrë fonde para

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*

zgjedhore. Ky është vetëm për ato që nuk kanë marrë fonde para zgjedhore dhe kanë arritur 1% në këto zgjedhje.


Z. I. Celibashi: Pra, ideja është kjo: qëllimi i këtij projektvendimi është që të kompensojë me fonde ato subjekte që para zgjedhjeve nuk kanë marrë fonde. Janë vetëm tre subjekte që nuk kanë marrë fonde parazgjedhjeve PAA, PLL, PBDNJ. Të gjitha subjektet e tjera, partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, kanë marrë fonde. Në këtë akt, në qoftë se do të ishte rasti do t'u jepeshin para atyre partive të cilat nuk kishin marrë fonde. Pra, ne nuk bëjmë kompensimin, thjesht përfitojnë fonde ato që nuk kanë mundur t'i marrin, me kushtin që të kenë kaluar 1%. Rezulton se asnjëra prej atyre nuk e ka kaluar 1%, kështu që nuk e përfitojnë.

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Dakord, zoti Kryetar, shumë e qartë, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Diskutime të tjera nuk kemi?! Atëhere,
Në mbështetje të neneve 19, paragrafi 1, shkronjat “k” e “n”, paragrafi 2, si dhe nenin 89 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Vendimin nr.21, datë 13.07.2021 të Komisionit Rregullator “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”,
Vendos:

1. Të mos shpërndaj kompensim financiar paszgjedhor për të gjitha subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes.

Vendimi nr. 429

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të partive politike për vitin kalendarik 2020 dhe sanksionet për mosdorëzimin e tyre”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, V.Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PDIU, PBD**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës që ka të bëjë me dorëzimin e raporteve financiare.

Z. Y. Merkaj: Neni 23, i ligjit “Për Partitë Politike”, parashikon se partitë politike kanë detyrimin të dorëzojnë raportin financiar 1 (një) herë në vit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky raport duhet të dorëzohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës në referuar vendimit nr. 14. datë 23.11.2012 të KQZ “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 3, datë 18.01.2012 “Për miratimin e rregullave për formatet e standardizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar nga ekspertet kontabël”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në fillim të vitit kalendarik i ka dërguar shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilën është kërkuar numri i partive politike të regjistruara në Gjykatë. Referuar shkresës me nr. 511/1 prot. datë 26.01.2021 të ardhur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve*

Dt.22.07.2021

Tiranë, partitë politike të regjistruara pranë Gjykatës janë 131 (njëqind e tridhjetë e një). Referuar nenit 23, pika 1, të ligjit “Për partitë politike”, partitë politike të cilat kanë dorëzuar pasqyrat financiare vjetore, për vitin kalendarik 2020, janë si më poshtë vijon:

1. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;
2. Partia Kristian Demokrate;
3. Partia Demokratike e Shqipërisë;
4. Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare;
5. Partia Socialdemokrate;
6. Partia Socialiste e Shqipërisë;
7. Partia Bashkimi Liberal Demokrat;
8. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet;
9. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut;
10. Partia Lista e Barabartë;
11. Partia Demokraciasociale;
12. Partia Demokristiane e Shqipërisë;
13. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare;
14. Partia Fryma e Re Demokratike;
15. Partia Republikane Shqiptare;
16. Partia Socialiste e Moderuar;
17. Partia Aleanca Popullore;
18. Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet;
19. Partia Lëvizja e Re;
20. Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane;
21. Partia Lëvizja për Ndryshim.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*

Partitë politike, të cilat kanë dorëzuar raport vjetor financiarë për vitin kalendarik 2020, pas datës 31 Mars 2021, janë si më poshtë:

1. Partia Lëvizja e Legalitetit;
2. Partia Minoriteti Etnik Grek;
3. Partia Zgjidhja;
4. Partia e Gjelbër.

Partitë politike, të cilat nuk kanë dorëzuar raport vjetor financiar janë 106 (njëqind e gjashtë), si më poshtë vijon:

1. Partia Punës Shqipërisë;
2. Partia për Europianizim dhe Integrim të Shqipërisë;
3. Partia Liri, Demokraci dhe Etikë;
4. Partia Balli Kombëtar;
5. Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet;
6. Partia Ora e Shqipërisë;
7. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar;
8. Partia Përparimi Kombëtar i Shqipërisë;
9. Partia e Blertë Shqiptare;
10. Partia Uniteti Kombëtar;
11. Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë;
12. Partia Universale Shqiptare;
13. Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë;
14. Partia Liberale Shqiptare;
15. Partia Ekologjike;
16. Partia Socialpunëtore e Shqipërisë;
17. Partia Socialreformiste e Shqipërisë;
18. Partia Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare;


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*

19. Lëvizja Demokratike për Vlëra, Mirëqënie, Progres;
20. Partia Alternative Republikane;
21. Partia Konservatore;
22. Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar;
23. Partia Bashkësia Kombëtare Shqiptare;
24. Partia Triumfi i Legalitetit;
25. Partia Rimëkëmbja Kombëtare;
26. Partia Centriste Mirëqënies Popullore Shqiptare;
27. Partia Pajtimit Kombëtar;
28. Partia Demokracia e Re Europiane;
29. Partia Lidhja Kombëtare Shqiptare;
30. Partia Qytetare Shqiptare;
31. Partia Alternativa Liberale e Shqipërisë;
32. Partia Komuniste e Shqipërisë;
33. Balli Kombëtar Demokrat;
34. Partia Kombëtare Konservatore Albania;
35. Partia e të Majtës Demokratike Shqiptare;
36. Partia Ambientaliste;
37. Partia Aleanca Nazionale Shqiptare;
38. Partia Reformave Demokratike Shqiptare;
39. Partia Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare;
40. Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare;
41. Partia Demokrate e Re;
42. Partia Mendimi i Djathtë Liberal;
43. Lëvizja për Zhvillim Kombëtar;
44. Partia Demokracia Paqësore e Shqipërisë;


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*

45. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve;
46. Partia Aleanca Socialiste Shqiptare;
47. Partia Sigurisë Kombëtare Shqiptare;
48. Partia Shpresa Demokrate;
49. Partia Ardhmërija Shqiptare;
50. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Puntorëve të Shqipërisë;
51. Partia Emigracioni Shqiptar;
52. Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori;
53. Partia Demokratike Peza Gjirokastër e Shqipërisë;
54. Partia Integritit Social Kombëtar Shqiptar;
55. Partia Lidhja e Blertë Shqiptare;
56. Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim European;
57. Partia Lëvizja për të Drejtat e Njeriut;
58. Partia Shqiptare Atdheu;
59. Partia Demokracia e Re e Djathtë Shqiptare;
60. Partia e të Drejtave të Mohuara;
61. Partia e Çështjeve Shqiptare;
62. Partia Fronti i Majtë;
63. Partia Shqipëria e Re;
64. Partia Lëvizja Elitare Kombëtare;
65. Partia Shqiptare e Rindërtimit;
66. Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare;
67. Partia e të Drejtave të Mohuara – e Re;
68. Lista për Shqipëri Natyrale;
70. Partia Progresi Social Kombëtar;
71. Partia Aleanca për Europën;


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*

72. Partia Demokratike e Bashkimit Myslyman të Shqipërisë;
73. Partia “Ligj dhe Drejtësi”;
74. Partia Socialiste e Vërtetë 91;
75. Partia G99; 76. Partia Toleranca e Re e Shqipërisë;
77. Partia Aleanca Europiane Ekologjike;
78. Partia Aleanca Arbnore Kombëtare;
79. Partia Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve;
80. Partia Personat me Aftësi të Kufizuar;
81. Partia Lëvizja Shqipëria e Re;
82. Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar;
83. Partia Lidhja për Drejtësi dhe Progres;
84. Partia “Aleanca Kuq e Zi”;
85. Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim;
86. Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë;
87. Partia “Forca Rinia”; 88. Partia “Shkodra 2015”;
89. Partia “Sfida për Shqipërinë”;
90. Partia Bindja Demokratike;
91. Partia “Lëvizja Demokratike Shqiptare”;
92. Partia Independentëve (Centriste) të Shqipërisë;
93. Partia Nacional Demokrate e Shqipërisë;
94. Partia Lidhja Popullore Shqiptare;
95. Partia Nacionaliste Shqiptare;
96. Partia e Djathtë Demokratike e Shqipërisë;
97. Partia Drejtësia Shoqërore;
98. Partia Progresi Demokratik;
99. Partia Mbrojtja e të Drejtave Kombëtare;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*

100. Partia e Re Socialiste e Shqipërisë;
101. Partia Ideali Demokratik Shqiptar;
102. Partia Lëvizja për Demokraci;
103. Partia Ideali komunist;
104. Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë;
105. Partia e Biznesit Shqiptar;
106. Aleanca Popullore për Drejtësi.

Nga këto 106 (njëqind e gjashtë) parti politike, të cilat nuk kanë dorëzuar raport vjetore financiare janë 11 (njëmbëdhjetë) parti politike që kanë qenë pjesë e zgjedhjeve të datës 25 prill 2021 dhe janë:

1. Partia Balli Kombëtar;
2. Partia Ora e Shqipërisë;
3. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar;
4. Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë;
5. Ballo Kombëtar Demokrat;
6. Partia Kombëtare Konservatore Albania;
7. Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar;
8. Partia Emigracioni Shqiptar;
9. Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar;
10. Partia Bindja Demokratike;
11. Partia “Lëvizja Demokratike Shqiptare”.

Bazuar në nenet 23 dhe 23/4, pikat 3 dhe 4, të ligjit “Për Partitë Politike”, i kemi propozuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve marrjen e masës administrative, gjobë në masën 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë për 106 (njëqind e gjashtë) partitë politike që nuk kanë dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raport vjetor financiar duke refuzuar për të bërë transparente burimet e financimit apo për të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*

lejuar ushtrimin e kontrollit nga ana e ekspertëve. Gjithashtu dhe marrjen e masës administrative, gjobë në masën 50 000 deri në 100 000 lekë për 4 (katër) partitë politike që e kanë dorëzuar raportin vjetor financiar 2020 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve jashtë afatit të përcaktuar në ligj. Projektvendimi për shqyrtim dhe miratim është dorëzuar pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësues të partive politike për diskutim?

Përfaqësues i Partisë Bashkimi Demokrat: Faleminderit zoti Kryetar, Partia Bashkimi Demokrat. Edhe ne jemi nga partitë që nuk kemi dorëzuar bilancin financiar të vitit 2021, por meqenëse viti 2020, nuk ka qenë një vit normal, ka qenë vit pandemie. Po ashtu dhe për vitin 2019, bilancet financiare u la kohë të dorëzoheshin deri më 30 shtator, kërkoj nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në qoftë se është e mundur të na lerë një afat qoftë dhe një javë që ne ta dorëzojmë këtë bilanc financiar.

Z. I. Celibashi: Në mos gaboj, ne kemi bërë një shtyrje?!

Znj. V. Ballgini: Shtyrja që ne kemi bërë ka qenë në lidhje me auditimin e raporteve të dorëzuara, duke qenë se ishte fushatë dhe i binte që auditimi të kryhej në muajin e fushatës, kështu që u shty.

Përfaqësues i Partisë Bashkimi Demokrat: Ne nuk kemi dijeni!

Z. I. Celibashi: Nuk ka të bëjë me këtë shtyrja. Atëherë, janë 106 parti nga 131 të regjistruara sipas aktit të sjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, të cilat nuk

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*

kanë dorëzuar raporte financiare deri më sot, në ditën që flasim nuk e kanë dorëzuar raportin. Përtej këtyre 106, janë katër që e kanë dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar.

Përfaqësues i Partisë Bashkimi Demokrat: Mund ta sjell për dy ditë bilancin, më jepni kohë vetëm dy ditë?

Z. I. Celibashi: Më vjen keq që e them, por ne nuk e shtyjmë dot afatin, sepse është i përcaktuar nga ligji dhe Komisioneri Shtetëror nuk ka kompetencën për ta shtyrë këtë afat. Do të duhej që kjo kërkesë të ishte bërë më parë që Komisioni Rregullator, i cili e ka kompetencën, nëse nuk gaboje, për të vendosur në lidhje me këtë me këtë çështje që duhet të kishte marrë vendim. Prandaj e bëra pyetjen për administratën që këto 106 parti, jo vetëm që nuk e kanë sjellë në afat, por nuk e kanë sjellë fare edhe sot në ditën që ne jemi duke e shyrë. Të themi edhe për ato arsye që ju përmendët nuk ka qenë e mundur që ta sillnit brenda 31 marsit, por sot jemi në 22 Korrik, kështu që nuk mund të vendosim afat tjetër. Kemi diskutime të tjera? Atëherë,

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” dhe pika 2 të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, dhe nenet 23 dhe 23/4, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, si dhe vendimit nr. 14. datë 23.11.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.3, datë 18.01.2012 “Për miratimin e rregullave për formatet e standardizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar nga ekspertet kontabël”, pra vendimit të KQZ-së,

Vendos:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.07.2021*

1. Marrjen e masës administrative, gjobë në masën 1 000 000 lekë për partitë politike që nuk kanë dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raport vjetor financiar, sipas lidhje 1, pra 106 parti.
 2. Marrjen e masës administrative, gjobë në masën 50 000 lekë për 4 (katër) partitë politike që e kanë dorëzuar raportin vjetor financiar 2020 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve jashtë afatit të përcaktuar, sipas lidhje 2.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve. Faleminderit!
- Çështje të tjera nuk kemi, seanca mbyllet, ditën e mirë!

Vendimi nr. 430

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

